

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**

<b>Nr. Rendor</b>	<b>Data e kërkesës</b>	<b>Objekti i kërkesës</b>	<b>Data e përgjigjes</b>	<b>Përgjigje</b>	<b>Mënyra e përfundimit të kërkesës</b>	<b>Tarifa</b>
1	30.03.2023	Kërkesë për informacion deleguar nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me statistika për ndihmën juridike të garantuar nga shteti për vitin 2022 nga The Kvinna till Kvinna Foundation	04.04.2023	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i vuri në dispozicion Analizën e Performancës për vitin 2022 ku mund të aksesohen të gjitha të dhënat statistikore të nevojitura.	E plotë	Nuk ka
2	10.03.2023	Kërkesë për vënien në dispozicion të targave të automjeteve ekzistuese në pronësi të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.	21.03.2023	Email ku u bë me dije se Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas nuk disponon automjet.	E plotë	Nuk ka
3	21.02.2023	Kërkesë për informacion deleguar nga Ministria e Drejtësisë mbi qytetarin A.M “Nëse të dhënat e tij personale po përpunohen automatikisht nga ndonjë institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe nëse po, për çfarë qëllimi?	27.02.2023	Në kuadër të kërkesës tuaj deleguar nga Ministria e Drejtësisë, ju bëjme me dije se disponohen të dhënat tuaja nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë. Sipas ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, “Qendër shërbimi e ndihmës juridike parësore” është një njësi e specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Të dhënat e deklaruara nga ana juaj me datë 05.05.2022 pranë Qendrës, ruhen dhe	E plotë	Nuk ka

				përpunohen sipas Udhëzimit nr.1 datë 8.3.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”, bashkëlidhur këtij emaili dhe Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” për mbrojtjen e të dhënave personale”		
4	04.10.2023	<p>Kërkesë për informacion nga organizata “Drejtësi Sociale”. Bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit, kërkojmë informacion nga Drejtoria e Ndihmës Juridike:</p> <p>Sipas nenit 25 te Kreut VI te Ligjit nr. 111/2017 datë 14. 12.2017 Për Ndihmën Ligjore të garantuar nga shteti, personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga: pika b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertel, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas percaktimeve të legjislacionit procedural. A përfshihet tek pika b</p>	09.10.2023	<p>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është person juridik publik, ku në fokus ka të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë.</p> <p>Sipas Nenit 25 të Ligjit nr.117/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti” Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:</p> <p>a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;</p> <p>b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;</p> <p>c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror;</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>edhe mbulimi i shpenzimeve për kryerjen e testit të ADN kur procesi e kërkon?</p> <p>Sa analiza të ADN ka mbuluar Drejtoria e Ndhmës Juridike për vitin 2022 dhe 6 mujorin e parë të 2023, që janë kërkuar në procese gjyqësore për zgjidhje martesë?</p>		<p>Ju bëjmë me dije se pikën b të nenit 25 përfshihet edhe mbulimi i shpenzimeve për kryerjen e testit të ADN-së.</p> <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për vitin 2022 ka likujduar vetëm 2 raste, ndërsa për 6 mujorin e parë të 2023 nuk kemi asnjë rast.</p>		
5 <sup>1</sup>						

---

<sup>1</sup> Nuk janë administruar më kërkesa për informacion